Kronikë

Shkodër/ Të shtëna në bjeshkët e Munellës! 37-vjeçari: Kemi konflikt me një bashkëfshatar, gjeta tabelë me mbishkrimin 'Ik se do vdesësh'! Policia gjen 6 gëzhoja

Një ditë më parë është qëlluar me armë në Munellë, aty ku ka stanin e bagëtive familja Nikolli nga Spaçi i Mirditës. Erjon Nikolli, 37 vjeç, ka bërë denoncimin në polici. Ai rrëfen për mikrofonin e Report TV se, përpos krismave të armëve, ka gjetur dhe një mesazh: "Ik ose do vdesësh."

Redaksia
3 Gusht, 10:19 | **Përditesimi: 3 Gusht, 16:12**

Share

SHKODËR - Një ditë më parë është qëlluar me armë në Munellë, aty ku ka stanin e bagëtive familja Nikolli nga Spaçi i Mirditës. Erjon Nikolli, 37 vjeç, ka bërë denoncimin në polici. Ai rrëfen për mikrofonin e Report TV se, përpos krismave të armëve, ka gjetur dhe një mesazh: "Ik ose do vdesësh."

Erjon Nikolli tregon se familja e tij është traumatizuar, përfshirë bashkëshortja shtatzënë.

> *"Jemi zgjuar dje me krisma armësh. Unë këtu rri me gjithë familjen time, që kam nusen, 2 fëmijët, kam patur dhe kunatën me gjithë fëmijën e vet, nusen e kam shtatzanë. Kemi lajmëruar policinë, ka ardhur policia, kemi shkuar atje ku kanë gjuajtur me armë, kemi gjetur një tabelë ku shkruhej "Ik se do vdesësh". Policia mori dhe gëzhoja armësh. Për të pasur konflikt, kemi një bashkëfshatar që mund të themi se rri këtej. Unë bagëtitë kullos o vëlla. Nuk kam çfarë të them. I bëj thirrje kryeministrit, kryetarit të bashkisë, të gjithë instancave të më japë zgjidhje se kam ardhur vetëm për të punuar. Nga jashtë shtetit, kam ardhur për të investuar gjithë djersën e familjes time, me bagëti. Asgjë nuk po kuptoj",- thotë Erjon Nikolli.*



LEXO EDHE:
Pukë, shpëtohen 2 turistë holandezë në Majën e Murgës! Emanuel Pjetri apelon: Mos merrni malet pa udherrëfyes

Ndërkohë, policia e Pukës ka gjetur 8 gëzhoja nga një pushkë dhjetëshe, ndërsa ende nuk ka një njoftim për zbardhjen e kësaj ngjarjeje.

> *"Ditën e djeshme shtetasi E. N., 37 vjeç, banues në fshatin Spaç, ka kallëzuar se në largësi të Stanit të tij, në bjeshkët e Munelles, në fshatin Mesul, kanë qëlluar me armë zjarri në ajër. Në vendin e ngjarjes kanë shkuar menjëherë shërbimet e Policisë të cilët kanë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 6 gëzhoja", njoftoi sot policia.*

Në malin e Munellës këtë vit janë vetëm tre stane nga dhjetëra të tillë që kishte dikur, çfarë do të thotë se ka hapësirë të mjaftueshme për kullotat, për të cilat familja Nikolli thotë se ka shkrepur arma.

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: erjon nikolli | Shkodër | të shtëna me arme | gëzhoja

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 3 Gusht, 06:37

Çfarë mendoni për ndryshimet e propozuara me draftin për Kodin e ri Penal?

Jam pro | Jam kundër | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Shkodër/ Ndotja akustike, Policia aksion për matjen e nivelit të zhurmave dhe garantimin e qetësisë publike!
3 Gusht, 12:28

Rrezikuan jetën e pushuesve, policia bllokon 20 mjete lundruese nga Komani në Ksamil! Gjobiten me nga 1 mln lekë drejtuesit
3 Gusht, 12:16

Shkodër/ Asgjësohen 16 mijë e 755 bimë kanabis! Sekuestrohen edhe 320 kg degë kanabisi me boçe, nuk dihen kultivuesit (VIDEO)
3 Gusht, 10:30

Pukë/ Dy turistet holandezë humbin rrugën në malet mbi liqenin e Komanit, Policia i shpëton! Njëra ishte dëmtuar (VIDEO)
2 Gusht, 20:19

Ekskluzive/ 'Fshati turistik' pa leje në Theth, i vetmi për të cilin prokuroria s'nisi hetimin! Për 6 muaj policia referoi 34 raste, akuza regjistroi 33

Sokol Dema

2 Gusht, 12:17

Rregullohen 17 kilometrat e para të Rrugës së Dukagjinit, nisin punimet në lotin e dytë Kir-Ndërlysaj (VIDEO)
2 Gusht, 11:43

Pas rikthimit në identitet të fshatit turistik, çifti lidh kurorë në Kishën e Thethit (VIDEO)
1 Gusht, 18:45

Bashkia Shkodër vëmendje të shtuar për institucionet kulturore, në rikonstruksion Teatri 'Migjeni' dhe Kinema 'Republika'

Ergys Kavaja

1 Gusht, 14:49

Shkodër/ Goditën me sende të forta dhe thikë 42-vjeçarin pas një sherri, pranga dy vëllezerve
1 Gusht, 11:01

Shkodër/ Plagosi me thikë një 42-vjeçar për motive të dobëta, policia arreston autorin (VIDEO)
31 Korrik, 18:51

Vau i Dejës/ Kishte kultivuar 180 bimë kanabis, arrestohet 27-vjeçari! Në kërkim një i mitur
31 Korrik, 13:50

Bashkia Shkodër shkarkoi dy aktorët e teatrit 'Migjeni', Shkreli dhe Doda: Vendimi me prapavijë politike

Ergys Kavaja

30 Korrik, 15:42

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje